

V E N D I M
Nr.531, datë 21.8.1998

PËR TOKAT BUJQËSORE TË PANDARA

Në zbatim të ligjit nr.8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Sipërfaqet e tokave bujqësore të pandara, që janë nën administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve e Kullotave, dhënë me ligjin nr.8047, datë 14.12.1995 "Për administrimin e tokave të refuzuara", të kalojnë në administrimin e këshillave të komunave ose të bashkive.

2. Kalimi i sipërfaqeve të bëhet me procesverbal, në prani të përgjegjësit të zyrës së kadastrës, drejtorit të bujqësisë dhe ushqimit, drejtorit të shërbimit pyjor të rrethit dhe të kryetarit të komunës ose të bashkisë.

Si dokumentacion bazë për kalimin e tokave të pandara të shërbejë procesverbali, i cili të shoqërohet edhe me pasqyrimin grafik.

3. Ndarja e tokave bujqësore të pandara të bëhet duke ruajtur përparësitë, sipas radhës së mëposhtme:

a) u ofrohen për t'u marrë në pronësi familjeve bujqësore ose individëve, të cilëve u janë dhënë në bazë të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", por që i kanë refuzuar.

b) u jepet pronësi, për t'u plotësuar me normë të plotë për frymë, familjeve fshatare, që me ligjin nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" kanë marrë tokë bujqësore 1/2 e normës për frymë.

c) u jepet në pronësi familjeve që përfitojnë të drejtat sipas nenit 5 dhe 6 të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë" dhe që janë subjekt i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën".

4. Sipërfaqet e tokave të pandara të evidentohen më vete.

5. Familjet fshatare apo individët që do të trajtohen me ligjin nr.8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" detyrohen ta përdorin atë sipas dispozitave të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", me ndryshimet përkatëse, si dhe akteve nënligjore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano